KËSHILLI I NDERIT PRANË SHOQATËS SË GAZETARËVE TË MAQEDONISË , SHGM, në seancën e mbajtur më 20.04.2023, duke vepruar pas parashtresës së dorëzuar nga **Ivan Mirçevski, drejtues i TV Kanal 5 kundër portaleve "Maktell" dhe "Naroden Gllas" si dhe parashtresën e Rubin Ivanovskit nga "Naroden Gllas" kundër informacionit të TV Kanal 5**, e solli këtë

VENDIM

1.Pranohet parashtresa e Kanal 5 dhe KONSTATOHET GJUHË E URREJTJES NGA ANA E Sashe Ivanovskit dhe PORTALIT "MAKTELL",
2.Pranohet parashtresa e Rubin Ivanovskit nga "Naroden Gllas" Prilep kundër Kanal 5 dhe konstatohet se është përmenduar në kontekst të gjerë pa prova,

ARSYETIM

Ivan Mirçevski, drejtues i TV Kanal 5, deri tek Këshilli i Nderit dorëzoi informacion, i cili ishte dërguar edhe në MPB dhe PTHP Shkup, në të cilën thekson se portalet "Maktell" dhe "Naroden Gllas" në mënyrë të sinkronizuar e prishin imazhin e televizionit dhe gazetarëve, me atë që publikojnë tekste dhe tituj që përmbajnë gjuhë të urrejtjes dhe kërkon nga institucionet që të reagojnë në mënyrë adekuate.

Duke shqyrtuar provat e ofruara, titujt e publikuar në portalin "Maktell", Këshilli i Nderit konstaton se të njëjtat përmbajnë gjuhë të urrejtjes, që devijon nga forma e kritikës , nëse dikush i interpreton ashtu, dhe e inkurajon televizionin që të kërkojë mbrojtje institicionale pasi që bëhet fjalë për vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare. Këshilli i Nderit pranë SHGM-së e dënon çdo lloj forme të gjuhës së urrejtjes në çfarëdo baze.

Këshilli i Nderit, në bazë të provave të dorëzuara nga Ivan Mirçevski dhe Kanal 5, nuk ka konstatuar shkelje nga ana e portalit "Naroden Gllas" siç është theksuar në parashtresë, respektivisht në kallëzimin në MPB.

Njëkohësisht, deri tek Këshilli i Nderit ka dorëzuar parashtresë edhe Rubin Ivanovski nga "Naroden Gllas" i Prilepit I cili reagon se pohimet se ai së bashku me portalin "Maktell" shpërndajnë gjuhë të urrejtjes që ishte publikuar në një tekst të portalit në Televizionin Kanal 5, me çka është sulmuar dhe shpifur në mënyrë të pabazë.

Këshilli i Nderit konstatoi se në tekst, Rubin Ivanovski përmendet në mënyrë të përgjithshme, pa u theksuar se çfarë ka bërë, përveç siç theksohet, ka nënshkruar tekste në emrin e tij, që paraprakisht janë publikuar në "Maktell".

Këshilli i Nderit nuk u bind nga argumentet e TV Kanal 5 dhe parashtruesit Ivan Mirçevski, dhe konstatoi se është e paparanueshme që të përmenden emra në kontekst të përgjithshëm, pa prova, siç është rasti me Rubin Ivanovskin , dhe për këtë arsye, parashtresën e tij e pranoi si të bazuar.

Vendosur në Shkup, më 20.4.2023

KËSHILLI I NDERIT PRANË SHGM

Kryetar i Këshillit

Sashe Dimovski